

VENDIM
Nr. 805, datë 29.12.2017

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 383, DATË 19.5.2010, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË SHPËRNDARJES SË
FONDIT TË KOMPENSIMIT NË VLERË PËR PRONARËT E PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMET INFORMALE”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 7, të vendimit nr. 383, datë 19.5.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Në rast se në listat e përfituesve, të miratuara me vendime të Këshillit të Ministrave, konstatohen gjenealitete të ndryshme të subjekteve nga ato faktike të tyre, atëherë ATP-ja ka të drejtë të verifikojë dhe të provojë, bazuar në të dhënat e përgjithshme të pasurisë dhe të trashëgimisë të marra në institucionet e treta, se gjenealitetet e subjekteve përfituese janë të njëjta me ato të subjekteve të publikuara në listat e vendimeve përkatëse të Këshillit të Ministrave.”.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia e Trajtimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama